

**Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe
reformat laicizuese në fushën arsimore.
Një qasje analitike e fokusuar në zonën e elbasanit**

**The temporary government of Vlora and the secularization
of public education.
An analytical approach focused on the area of Elbasan**

Abstract: *The foundation of a centralized and secularized public education was an important undertaking in the newly independent Albania. It aimed at the rejection of the power of the religious authority which was both much heterogenic and dividing at the same time for the plans lying ahead of the new Albanian state.*

In fact, the founding fathers wanted Albanian subjects to perceive the new state as lay and unifying; it could not possibly belong to any religion in particular. What ensued was the confirmation of the power of the new state over all other competitors.

The Temporary Government of Vlora extended secularization to different fields, including public education. Such process constitutes the fulcrum of the following study. The first part is a short history of the de-ottomanisation of public administration, whereas the second focuses on the implementation of such policy in Elbasan and the reaction of local society, considering such town as a case study. Intertwining theoretical and practical analysis against a cross-cultural approach highlights the salient features of the study.

Keywords: *de-ottomanisation, secularization, public education, national statehood, Government of Vlora, Elbasan.*

**Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe fillesat e procesit të
deosmanizimit në Shqipëri**

Akti vetëvendosës dhe shkëputës i shqiptarëve nga Perandoria Osmane, i ligjësuar me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në Vlorë nga Kuvendi Kombëtar i mbajtur aty, si edhe më tutje vendimi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër për krijimin e shtetit shqiptar, i vendosën institucionet dhe organizimin e tyre në një realitet të ri politik, juridik dhe administrativ, i ndryshëm nga ai ku ato kishin vepruar deri në atë moment. Ngritja e administratës shtetërore dhe vënia e saj mbi baza

ligjore u konsiderua detyrë e rëndësishme nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e formuar më 4 dhjetor 1912 nga Kuvendi Kombëtar si shprehje e vullnetit politik të shqiptarëve, por e panjohur nga Fuqitë e Mëdha si qeveri kombëtare. Ndonëse me autoritet të përkohshëm dhe të kufizuar territorial¹, ajo e përqendroi vëmendjen në çështje thelbësore të qeverisjes, njëra prej të cilave kishte të bënte me sendërtimin e sistemeve laike të centralizuara, një përpjekje kjo që shënon fillesat e një procesi të gjatë deosmanizimi dhe shtetformimi nëpër të cilin do të kalonin shqiptarët. Sikurse edhe në rastin e shteteve kombëtare të krijuara më herët në Ballkan, deosmanizmi u vështrua si një proces që duhej të realizonte idealin e dëshirueshëm të polit të kundërt me të qenurit osman ose oriental, më saktë europeanizimin, oksidentalizimin apo modernizimin e vijueshëm të shoqërisë.²

Në kuadrin e marrëveshjes shtetformuese të elitës politike shqiptare të përvijuar nga pjesëmarrësit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, shtyllat kryesore të së cilës lidheshin me europeanizimin e shtetit, gjithëpërfshirjen dhe përfaqësimin proporcional fetar të shqiptarëve në institucionet legislative dhe ekzekutive³, sendërtimi i sistemeve laike të centralizuara ishte një nismë e rëndësishme për Shqipërinë e asaj kohe. Shqiptarët do të duhej ta sendërtonin shtetin e tyre si laik⁴, që nuk i përkiste ndonjë feje të veçantë, por qëndronte mbi to. Kështu i hapej rruga krijimit dhe vendosjes së autoritetit të shtetit në të gjithë shoqërinë, rrjedhojë e së cilës do të ishte homogenizimi i marrëdhënies së shoqërisë me qeverisjen⁵ dhe universalizimi i procesit të shtetndërtimit me anë të një administrate

1 Në lidhje me hapësirën e kufizuar territoriale në të cilën ushtroi autoritetin Qeveria e Përkohshme e Vlorës shih: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi I, Botimet Albanologjike, Tiranë: 2017, 234-237.

2 Për më shumë në lidhje me procesin e deosmanizimit në shtetet ballkanike shih: Maria Todorova, *Ballkani imagjinar. Ballkani si alter ego e Europës*, përktheu Bashkim Shehu, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë: 2006.

3 Për më shumë në lidhje me tiparet e përfaqësimit të shqiptarëve në Kuvendin Kombëtar të Vlorës shih: Ledia Dushku, *Nga të mandatuar në kohë lufte, në të zgjedhur në periudhë paqeje: Një qasje krahasuese e tipareve të përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe Parlamentin e vitit 1921*, "Studime Historike" (2021), 1-2, 69-75.

4 Studiuesi Dominique Schnapper e konsideron laicitetin si një nga vetitë thelbësore të shtetit modern, në sajë të të cilit kapërcehet larmia e përkatësisë fetare, hirësohet kalimi i besimeve dhe praktikave në jetën private, ndërsa jeta publike bëhet një trevë asnjansë nga ana fetare dhe e përbashkët për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi të cilit ata i përkasin. Dominique Schnapper, *Bashkësia e qytetarëve: mbi idenë moderne të kombit*, Tiranë: Dituria, 2008, 58.

5 Në lidhje me procesin e homogenizimit të shoqërisë si një nga prioritetet e krijimit të shtetit kombëtar shih: M. Hakan Yavuz, *Warfare and nationalism. The Balkan Wars as a Catalyst for Homogenization*, "War and Nationalism. The Balkan Wars, 1912-1913, and Their Sociopolitical Implications", edited by M. Hakan Yavuz and Isa Blumi, The University of Utah Press, 2013, 33-35.

kombëtare, një sistemi arsimor të unifikuar, të një gjuhe, jo vetëm në nivel teorik, por edhe pragmatik. Në këtë mënyrë sistemi politik arrinte të hynte në kohezion me ndërgjegjen e shqiptarëve dhe institucionet e ndryshme fetare.⁶ Sigurisht që ky nuk mund të ishte një proces i lehtë, nisur nga fakti se vetë Perandoria Osmane nuk kishte qenë vend me një kohezion të fortë social apo me një shkallë të lartë integrimi social. Ajo jo vetëm që nuk kishte pasur ndjenjë integrimi në një shoqëri të përbashkët, por popullata ndiente se u përkiste grupeve të veçanta (fetare, sociale ose të tjetërlojta) që e kishin të vështirë të konvergonin me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë Perandoria Osmane nuk kishte krijuar një shoqëri të integruar, madje as nuk ishte përpjekur medoemos të arrinte një integrim të tillë.⁷

Ashtu sikurse kishte ndodhur më herët me shtetet kombëtare në Ballkan, edhe me shqiptarët mori jetë i njëjti proces. Me të hyrë në rrugën e përpjekjeve për të krijuar një identitet solid kombëtar, elita politike në qeverisjen e vendit, në rastin konkret Qeveria e Përkohshme e Vlorës, u mundua të përcaktonte vija ndarëse ndërmjet vetes dhe ish drejtuesve osmanë. Kjo bëhej në kuadër të një retorike të caktuar kombëtare, e cila ishte e papajtueshme në thelb me konceptin perandorak e mbikombëtar që vetë Perandoria Osmane përfaqësonte.⁸ Ishte një ide kombëtare e mbështetur më së shumti në etnicitet, me një bërthamë të fortë gjuhësore. Synimi ishte të rrokej karakteri themelor i gjuhës në përcjelljen dhe riprodhimin e traditave, të cilit do të duhej t'i mëshohej fort nëpërmjet reformës gjuhësore.⁹ Nisur nga fakti se ndër shqiptarë nacionalizmi u konturua para së gjithash mbi identitetin gjuhësor, elita kulturore dhe ajo drejtuese politike me të drejtë e konsideroi gjuhën si faktorin më të fuqishëm të unifikimit ndër shqiptarë. Për më tepër, duke këmbëngulur në një sistem unik dhe laik arsimor, do të arrihej të vendosej edhe kontrolli i shtetit mbi vetë kulturën në tërësi.¹⁰

Si rrjedhojë, përpjekjet e autoriteteve drejtuese shqiptare u përqendruan në krijimin e një sistemi arsimor të laicizuar, të centralizuar dhe të unifikuar, i cili krahas krijimit të një force të armatosur, do të ishte një nga shtyllat më solide, me impakt pozitiv në funksion të nacionalizmit dhe të rritjes së ndjenjës kombëtare te shtetasit shqiptarë. Programi arsimor

6 Sokol Gjermani, *Aspekte të jetës së komuniteteve fetare në Shqipëri përgjatë vitit 1913*, "Studime Historike" (2013), 1-2, 86.

7 Todorova, *Ballkani imagjinar*, 243.

8 Për më shumë në lidhje me retorikën deosmanizuese të përdorur në ligjërimitin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës shih: Ledia Dushku, *T'a heqim synë nga Turqia!* Perceptimi rreth turqve Osmanë në ligjërimitin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, "Studime historike" (2015), 3-4, 67-89.

9 Todorova, *Ballkani imagjinar*, 243, 262.

10 Yavuz, *Warfare and nationalism*, 34.

i përvijuar nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, ku rolin qendror e luajti ministri i Arsimit Luigj Gurakuqi, e plotësonte panoramën edhe me lejimin e shkollave të huaja profesionale vetëm në ato qytete ku grupet e të huajve ishin në numër të konsiderueshëm; me bërjen të detyrueshëm të arsimit fillor, sikurse edhe të gjuhës shqipe në shkollat e çdo lloji që vepronin në Shqipëri; me përgatitjen e centralizuar të mësuesve përmes shkollave normale dhe kurseve pedagogjike, të cilat do të duhej të funksiononin vetëm përmes legjislacionit të miratuar nga qeveria.

Në zbatim të kësaj politike, në gusht të vitit 1913, qeveria shqiptare “vendosi që të çilet në çdo sundimtari nga një normale përgatitore ku nxënësit do të pranoheshin mbi bazën e disa kushteve”.¹¹ Kushtet caktoheshin në urdhrin e Ministrisë së Arsimit, sipas të cilit, shkolla fillore ishte e detyrueshme për të gjithë nxënësit e Shqipërisë, kurse shkollat e veçanta do të funksiononin vetëm pasi të kishin plotësuar kriteret e përcaktuara në ligj.¹² I gjithë sistemi arsimor duhej t’u nënshtrohej ligjeve të shtetit shqiptar. Shkollat duhej të funksiononin vetëm pasi të merrnin leje zyrtare nga qeveria, të kishin programe, libra të njohura nga Ministria e Arsimit. Mësimi, përfshirë edhe shkollat e komuniteteve fetare e të huaja, duhej të bëhej në gjuhën shqipe. Shkollat publike, në varësi të madhësisë së vendbanimit, ishin 3, 4 dhe 5-vjeçare. Lëndët kryesore ishin gjuha shqipe, historia, aritmetika, kënga dhe gjmnastika.

Për Mihal Gramenon, një nga figurat e zëshme të nacionalizmit shqiptar, evidentohet se “Urdhërim i Zotit Ministri t’Arësimit bashkë me qarkorën që dha në Shqipëri do të mbushë plot gëzim zemrat e gjithë Shqipëtarëve për të çelurit e shkollave fillore ... Është e tepërt besojmë që të rëfejmë, që pritja e kombit t’ënë qëndron në duart e profesorëve dhe mësionjësvet, se drita e përparimit që nga këta do të mburonjë andaj shërbimin më të madh që do t’i apën Shqipërisë është shërbimi i mësionjësvet ... Shkolla është themeli i kombit dhe sot një mësues mund të përhapë shkëndijën e diturisë ne i ngrati komb Shqipëtar”.¹³

Në funksion të kësaj politike, në zonat e kufizuara ku shtrinte autoritetin Qeveria e Përkohshme e Vlorës, nisën të vepronin shkollat fillore dhe të mesme, të cilat ishin të detyruara që mësimin ta zhvillonin në gjuhën shqipe. Sakaq u ngritën dhe filluan të funksiononin edhe drejtoritë arsimore, të cilat organizuan kurse për nëpunësit që të njihnin më mirë shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe, përdorimi i së cilës që prej 30 gushtit ishte bërë

11 *Urdhër i Ministrisë së Arsimit*, “Përlindja e Shqipënies”, Vit’i I, nr. 1, Vlorë, 24\6 gusht 1913, 2.

12 *Urdhër i Ministrisë së Arsimit*, “Përlindja e Shqipënies”, Vit’i I, nr. 10, Vlorë, 31 gusht\13 shtator 1913, 2.

13 Mihal Grameno, *Arësimi në Shqipëri*, “Përlindja e Shqipënies”, Vlorë, 4/17 Vjesht I, 1913, 2-3.

i detyrueshëm në administratën qendrore dhe atë lokale. Në Elbasan, Ministri i Arësimit emëroi si “drejtor shkolluar” Mustafa Krujën, veprimtar i dalluar i nacionalizmës shqiptare.¹⁴ Detyrat e “Drejtorit të Arësimit” u rregulluan me ligjin e njohur si “Kanuni i Përtashëm të Administratës Civile të Shqipëniës”. Respektivisht në artikujt 29 dhe 30 të tij, përcaktoheshin detyrat e drejtorit të drejtorisë arsimore, ndërsa në artikullin 31 vendosej që të ardhurat e vakëfeve të dikurshme të përdorëshin në shkollat e përgjithshme të komunitetit mysliman.¹⁵ Ministria e Arsimit i kushtoi rëndësi edhe përgatitjes së terminologjisë shqipe për degët e administratës, të arsimit dhe të sferave të tjera të jetës së vendit. Për këtë u ngrit një komision, i cili në qershor 1913 përgatiti fjalët dhe termat e nevojshëm në fushën e ushtrisë dhe të drejtësisë. Në nëntor të po atij viti qeveria parashikoi ngritjen e një qendre shkencore për studimin e çështjeve të gjuhës amtare, të programeve dhe të teksteve shkollore. Në thelb ky ishte projekti për themelin e një Akademie Kombëtare për çështjen e gjuhës dhe të programeve shkollore.

Elbasani si rast studimor i reformave për laicizimin në fushën arsimore

Në shtratin e parashtrësës së mësipërme, Elbasani përbën një rast interesant studimi sa i përket mjedisit dhe veprimtarisë së aktorëve socialë e politikë lokalë karshi politikës arsimore të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Kjo nuk ishte e rastësishme nëse merret parasysh trashëgimia pararendëse që mbarte dhe përfaqësonte ky qytet.

I vendosur në kryqëzim rrugësh, në një nga fushat më të bukura dhe më pjellore të Shqipërisë, Elbasani zotëronte një pozicion të rëndësishme gjeografik, në sajë të të cilit ai realizonte natyrshëm bashkimin mes toskëve dhe gegëve, mes ortodoksëve, myslimanëve, katolikëve e bektashinjve. Njëherazi ai lidhte Europën me hapësirën shqiptare dhe Ballkanin, për shkak se aty kalonte rruga Egnatia, një urë komunikimi mes detit Adriatik, hapësirës tokësore ballkanike e detit Egje. Në përshkrimet e udhëtarëve të huaj, qyteti vizatohej si një nga më të bukurit e vilajeteve të Rumelisë, i qarkuar me ullishte, me shtëpi të ulëta, fortesa e xhami piktoreske, me rrugë tregtare që shtriheshin mes për mes tij.¹⁶ Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe mbështetja në vazhdimësi që elita i kishte dhënë arsimit

14 “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 24/6 Vjesht e i-rë 1913, 5; “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 3 vjesht e i-rë 1913, 2.

15 *Kanuni i Përtashëm i Administratës Civile të Shqipëniës*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vit’i I, nr. 28, Vlorë, 23/6 dhjetor 1913, 3. Neni 29, 30 dhe 31 i Kanunit të Përtashëm të Administratës Civile të Shqipëniës.

16 Jacques Boucart, *Shqipëria dhe Shqiptarët*, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë: 2004, 164; Gabriel Louis – Jary, *Në Mbretërinë e re të Shqipërisë*, ASD- Studio, Tiranë: 2006, 36.

dhe kulturës amtare ishin faktorë të rëndësishëm që e kishin shndërruar Elbasanin në një vatër të qënësishme arsimore e kulturore me spektër të gjerë kombëtar. Kostandin Kristoforidhi, i njohur si “babai i gjuhës shqipe”, punoi me zell dhe përkushtim për shkrimin dhe lëvrimin e saj, sikurse edhe për hartimin e teksteve mësimore. Dëshira e vendasve për arsim dhe kulturë artikulohej qartë në artikujt e shtypit të fundshekullit XIX. “Vivlla kërkohen, shkolla hapenë, dhe ndë tërë vendin rrëfëhet një etje për mësim”, shkruante në nëntor të vitit 1897 gazeta “Shqipëria” organ i diasporës së Bukureshtit, ndërsa në fillim të shek. XX filloi të pasqyrohej edhe veprimtaria e klubeve patriotike elbasanase. Një i tillë ishte “Bashkimi”, anëtarët e të cilit bënë përpjekje të vazhdueshme për funksionimin e shkollave në gjuhën shqipe, me qëllimin e vetëm që “të mësojnë djemtë e vajzat gjuhën e vet”.¹⁷ Në shtator 1908 klubi hapi një kurs për mësuesit e gjuhës shqipe në shkollat e fshatrave të zonës, ndërsa një muaj më pas në qytet nisi të funksiononte një shkollë nate, që i zhvillonte mësimet në gjuhën shqipe.¹⁸

Moment kulmor në historinë e qytetit, por edhe të Shqipërisë, shënon organizimi në shtator 1909 i Kongresit të Elbasanit, një nga vendimet më të rëndësishme të të cilit ishte hapja e Shkollës Normale, e cila do të përgatiste mësues për shkollat shqipe. Në fund të vitit, vetëm pak muaj prej hapjes së saj, shkolla frekuentohej nga rreth pesëdhjetë nxënës, ndërsa në organet e shtypit evidentoheshin mbështetja e banorëve, të cilët, në kushtet e nevojës për mjedise, kishin shndërruar dyqanet në shkolla.¹⁹ Ekzistenca e Normales ndihmoi në formimin e një mjedisi intelektual e qytetar me frymë të spikatur kombëtare, i cili i kishte lënë mbresa edhe antropologes britanike, Mary Edith Durham. Në shkrimet e saj ku pasqyrohen përshtypjet e udhëtimeve në Ballkan, ajo i kushton vëmendje edhe Elbasanit, për të cilin shprehej se “... prekesh nga përpjekjet që bëhen për dije e kulturë. Gjen njerëz që pa kurrfarë ndihme japin e marrin me gramatikën frënge, madje edhe atë gjermane. Ka një numër mjaft të madh njerëzish të shkolluar dhe të ditur, po të merret parasysh fakti që në Perandorinë Turke nuk futen libra nga jashtë ... Elbasani ëndërron për një të ardhme të ndritur dhe vërtet pozita e tij në qendër të vendit do të ishte ideale për kryeqytet ...”²⁰

Në ligjërimin publik fill pas Shpalljes së Pavarësisë, qyteti në kërthizë të Shqipërisë konsiderohej si “më i lumturi” në lidhje me numrin e shkollave që vepronin në qytet dhe frekuentimin e tyre nga popullsia; i pari në radhë

17 Zhuljeta Kadilli Daja, *Sanxhaku i Elbasanit në kapërcyellin e shekujve XIX-XX. Aspekte të marrëdhënieve agrare*, Shëpia botuese “Mediaprint”, Tiranë: 2021, 66-67.

18 *Po aty*, 67.

19 Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit (1909-1912)*, Botimet “AlbPaper”, Tiranë: 2004, 145.

20 Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, botim i dytë, Shtëpia botuese “Naum Veqilharxhi”, Tiranë: 1998, 81-82.

ndër qytetet e Shqipërisë për nga “gjendja intelektuale (mendore)”.²¹ Të gjitha shkollat funksiononin në gjuhën shqipe në mbështetje me urdhëresat e nxjerra nga Ministria e Arsimit, ndërkohë që ishin mbyllur shkollat që më herët kishin funksionuar në gjuhën greke.²² Në fillim të vitit 1914 në qytet funksiononin tri shkolla fillore, prej të cilave njëra qendrore, me pesë rende, në të cilën mësonin 250 nxënës. Shkolla e dytë ishte ajo e Kalasë, me 80 nxënës, ndërsa e treta ajo e Shënkollit me 55 të tillë.²³ Hasan Meza, Mustafa Curri, Hysni Sefa dhe Emin Matraxhiu ishin disa prej mësuesve të emëruar nga Ministria e Arsimit si pjesë e trupës mësimore të këtyre shkollave.²⁴ Në qytet funksiononte edhe një shkollë fillore amerikane nën drejtimin e pastorit Charles Telford Erickson, e cila i nënshtrohej rregullave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit.²⁵ Ndërkohë që evidentoheshin përpjekjet e drejtuesve të drejtorisë arsimore të qytetit për të hapur edhe “një shkollë për çupat më të mirë ... , një si duhetë, me qenë se kjo që është sot nuk është pas nevojave të kohësë.”²⁶

Shkollat fillore filluan të funksiononin edhe në fshtrat përreth qytetit. Dallohej këtu Qukësi, qeveritari i të cilit, Qazim Matraxhiu, u angazhua personalisht për të bindur banorët që të ndihmonin dhe të ndërtonin godina për shkolla. Ai u kërkoi autoriteteve eprore emërimin e një mësuesi në fshatit Rajcë, pasi aty ekzistonte një ndërtesë e përshtatshme për shkollë, kërkesë e cila mori zgjidhje dhe Xhaferr Velçani nisi punën si mësues.²⁷ Një shkollë u hap edhe në Belsh, një fshat pesë orë larg qytetit, me një numër të konsiderueshëm banorësh, ndërsa si mësues atje u emërua Bedri Bejtja.²⁸

Që prej shtatorit 1913, Shkolla Normale nisi të funksiononte si shkollë e mesme përgatitore, qëllimi i së cilës ishte të përgatiste mësues për një periudhë të shkurtër disamujore, të cilët do të emëroheshin në shkollat e reja fillore që pritej të hapeshin në Shqipëri. Shpejt numri i nxënësve aty arriti në 130 syresh, 80 prej të cilëve vinin nga qytete të tjera shqiptare, pa përjashtuar këtu edhe Kosovën.²⁹ Pjesë e trupës arsimore ishin mësues me përvojë, integritet profesional e moral, ku dallonin: Aleksandër Xhuvani ish profesor i Normales së parë, Josif Haxhi Mima, ish mësues në gjimnazin e

21 *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 Shenendore 1913, f. 2; *Shkollat shqip*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2.

22 *Shkollat shqip*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2.

23 Haxhi Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2.

24 *Lajme të brendme. Nga Elbasani*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 21/3 Vjesht I, 1913, 5.

25 *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 Shenendore 1913, 2.

26 *Po aty*.

27 *Shkolla tjëra në Qukës*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 21/3 Vjesht I, 1913, 5.

28 “Shkollë në Belësh”, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 21/3 Vjesht I, 1913, f. 5.

29 Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2; *Të ra nga Shqipëria*, “Liri e Shqipërisë” Sofje, 28 vjesht e I-rë 1913, 1.

qytetit, si edhe Simon Shuteriqi.³⁰ Misioni, përbërja e nxënësve dhe trupa akademike i dhanë Normales së Elbasanit fytyrën e një shkolle kombëtare.

Ndërkaq në dhjetor 1913 në qytet u hap edhe një shkollë nate për meshkuj, nismë që u mbështet nga elbasanasit. Shkolla numëronte “gjer më 70 nxanës, në mes të cilëve ca janë 70 vjeç dhe disa të tjerë 10 vjeç”. Të gjithë manifestonin dëshirë “të mos mbesin më pas se nga ata që janë më të lumturë dhe kanë mësuar të shkrojnë e të këndojnë”. Shkollë kishte dy mësues Hasan Mezën dhe z. Fejza.³¹

Në qytet funksiononte edhe “një shkollë muzike”. Thanas Flloqi, gjykatës në gjykatoren e qytetit, jepte çdo mbrëmje nga një orë mësim muzike për 40 djelmosha. Këto mësimë ishin falas, ndërkohë që Flloqi punonte “me zell të madh për të formuar një bandë muzikore për qytetin, me mandolinë, kitarë, fyell, etj.”³²

Nëse mund të flasim për jetë akademike në Shqipërinë e pavarur, fillesat e saj i gjejmë në Elbasan. Ai ishte qyteti i vetëm ku që prej shtatorit 1913 organizoheshin “konference mi diturinë”. Këto organizime, që zhvilloheshin në sallonin e shkollës Normale, ishin leksione të hapura, të cilat mbaheshin nga veprimtarë të dalluar të nacionalizmës, njerëz me kulturë që shquheshin për dijen e tyre të shumanshme. Lektorët paguheshin nga Komisioni i Arsimit të qytetit. Leksioni i parë u mbajt nga Mid’hat Frashëri “më 13 të Vjeshtës së parë, për punë e Dibrës ku dëfteu punët e Serbëve që kurse filloj lufta balkanike, gjithë barbarizmat që kanë punuar gjer më tani dhe gjendja e keqe në të cilën gjenden sot vendet e shkelura prej sllavëve”.³³ Në vijim leksionet u bënë më të organizuara dhe periodike, një herë në javë. Mid’hat Frashëri vijoi t’i shpërfaqte elitës së qytetit dijet e tij, duke folur “mi qiellin, mi yjet, mi hapësirën. Atë natë kish më tepër se 200 dëgjonjës .., aq sa më të shumët ishin në këmbë”. Javën e dytë folës ishte Mustafa Kruja, drejtor i Drejtorisë Arsimore të Elbasanit, leksioni i të cilit kishte të dhëna të karakterit gjeografik dhe gjeologjik. Edhe atë natë salla ishte mbushur plot.³⁴

Në një qasje analitike dhe strukturore të informacionit të paraqitur më sipër, evidentojmë se në qytetin e Elbasanit ekzistonte një bërthamë e qënësishme intelektuale, ndonëse e vogël në numër krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë, e aftë për të jetësuar vendimet dhe urdhërat

30 *Lajme të brendme. Nga Elbasani*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 21/3 Vjesht I, 1913, 5.

31 Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2; *Shkollë nate*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë: 14/27 Dhetuar, 1913, 5; *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 Shenendre 1913, 2.

32 Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2; *Një orkestër*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 6/19 vjesht III 1913.

33 *Të ra nga Shqipëria*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 28 vjesht e I-rë 1913, 1.

34 Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2; *Shkollë nate*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë: 14/27 Dhetuar, 1913, 5.

e qeverisë së Përkohshme të Vlorës në lidhje me politikën arsimore. Në letrën dërguar nga Elbasani për gazetën “Liri e Shqipërisë” që dilte në Sofje, bëhej e ditur se “Njerëzit e këtij qyteti kanë virtyte të lartë, njerëzije dhe politike: se kurr gjermë sot s’është dëgjuar gjë e shëmtuar dhe e papëlqyer prej Elbasanit a prej Elbasanasve. Me mirësinë dhe sjelljen njerëzore dhe qytetore të njerëzisë, shto dhe synimin me të vërtetë të mirë dhe të zoti të Aqif Pashës [Biçakut] dhe do të kuptoni se kam të drejtë kur them se Elbasani është më i lumturi i qyteteve të Shqipërisë”. Në këtë mjedis spikatnin drejtuesit e drejtorisë arsimore dhe mësuesit e shkollave, njerëz të provuar dhe “të gjithë në lartësi të detyrës së tyre”.³⁵ “Një nga ata nëpunës ma të shkathët dhe punëtuës që ka Elbasani asht zotënia e tij Mustafa Asim Kruja, drejtor i Arësimit. Zotënia e tij asht duke u përpjekun për programën shkollore, në të cilën zbatohen dhe shkoqiten ma të pavërejtshme pika, ku nuk liqet në dyshim as fare mësonjësi.”³⁶

Përtelosin kombëtarist dhe europeist dalloheshin edhe korrespondentët e shtypit, të cilët me artikujt e publikuar mbështetën linjat e politikës europianizuese dhe deosmanizuese të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Një i tillë ishte Emin Matraxhiu, për të cilin modeli që shqiptarët duhej të ndiqnin do të duhej të ishte ai i revolucionit francez dhe fatet e modernizmit duhej t’i merrnin në dorë të rinjtë. Ja si shprehej ai në shkrimin e botuar në “Përlindjen e Shqipëniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës: “Të rinjt e kombëdashësit, vetëm ata e shpëtuanë Francën, të cilët duke u armatuar kundrejt dëshpërimit, dëbuar përtimin, atë armikun të njerzimit, i cili i poshtëron e varfëron popujt që fut në lak të tij, punuanë me shpres të pa tundur fituan të drejtat njerëzore edhe e lartësuanë Francën në këtë shkallë të cilën e kanë zilië bota”.³⁷

Mjedis pozitiv evidentohet edhe në administratën lokale të qytetit, ka veçohet zyra e drejtësisë, e cila i kryente detyrat e saj në gjuhën shqipe. “Përlindja e Shqipëniës” shkruan se “vetëm npunësit e kësaj zyrës së përmendun po bahen ngajë që t’i tregojnë popullit të padishëm randësiën dhe vleftën e gjuhës sonë, që ka me pas ajo mbaskëtaj”.³⁸

Por kjo nuk ishte fryma që mbizotëronte në mjedisin elbasanas. Kishte mjedise në qytet dhe kryesisht në fshatra, ku fillesat e politikës deosmanizuese u konsideruan të papërshtatshme, madje të rrezikshme për Shqipërinë. Dokumentacioni arkivor shqiptar bën me dije diskurin pro otoman që artikulohej në ato mjedise, si një përpjekje për të mbajtur larg popullsisë së zonës frymën kombëtariste shqiptare, për të mos pranuar

35 *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 Shenendre 1913, 2.

36 *Npunës të lavdushëm*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 2/15 Vjesht II 1913, 5.

37 Emin Matraxhiu, *Dëshpërimi, Përtimi*, Përlindja e Shqipëniës, Vlorë, 28/10 Vjesht e I, 1913, 2.

38 *Npunës të lavdushëm*, “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 2/15 Vjesht II 1913, 5.

realitetin dhe kundërshtuar vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, asnjans, nën garancinë e Fuqive të Mëdha, me në krye një princ të krishterë: “Ne jemi otomanë ... Sado që Shqipëria u nda, ju gjithë populli duhet të rini rehat si nënshtetas otomanë”, “do të sjellim Osmanllinë, do ta bëjmë Turqi Shqipërinë, do t’i kyçim shkollatë shqip dhe do të heqim “bajrak” osmanlli”.³⁹

Përfundime

Mbështetja që elita e spikatur elbasanase i dha programit arsimor të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës rezultoi të ishte e pamjaftueshme për të garantuar zbatimin e tij tërësor. Pavarësisht nga vullneti i treguar prej saj dhe qeverisë, realizimi i plotë i një sistemi arsimor kombëtar dhe laik si pjesë thelbësore e procesit të deosmanizimit të shtetit dhe shoqërisë shqiptare rezultoi të ishte një ndërmarrje jo e lehtë. Arsyet duhet t’i kërkojmë te situata e rënduar politike, rrjedhojë e përplasjeve të skajshme mes aktorëve dhe faktorëve politikë, e stimuluar edhe nga fakti se Qeveria e Përkohshme e Vlorës nuk u njoh nga Fuqitë e Mëdha si qeveri kombëtare⁴⁰, por gëzoi statusin e autoritetit lokal, sikurse edhe autoritetet e tjera qeverisëse që vepronin në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Veriut. Mungesa ndër shqiptarë e një jete të organizuar nën institucione kombëtare, mangësia e kultivimit të shqipes si një gjuhë e shkruar, si edhe infrastruktura e pamjaftueshme materiale dhe njerëzore janë të tjera arsye që shtuan vështirësitë në realizimin me sukses të reformave edhe në vitet vijuese. Në sferën e mentalitetit (besimi, zakonet dhe sistemi i vlerave të popullsisë) përpjekjet deosmanizuese rezultuan të ishin edhe më të zorshmet për t’u përqaftuar: shumica e popullsisë ishte fort e indoktrinuara nga modeli perandorak osman, çka e bënte përfshirjen sociale dhe integrimin e tyre organik në shtetin kombëtar dhe strukturat e tij administrative edhe më të zorshme. Në dallim nga popujt e tjerë në Ballkan, vështirësia rritej edhe për shkak të statusit të posaçëm që shqiptarët e besimit mysliman kishin patur në Perandorinë Osmane, çka bënte që propaganda në emër të fesë të zinte vend lehtë ndër ta. Për më tepër, në tërësinë e saj shoqëria shqiptare, sikurse edhe ajo ballkanike në momentin e shkëputjen nga varësia osmane, manifestoi një mosbesim endemik ndaj shtetit kombëtar. Për studiuesen Maria Todorova ky mosbesim buronte në një masë të madhe nga fakti se shteti osman ishte vështëruar në tërësi nga ballkanasit si institucion

39 *Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), A-IV-335*. Materiale arkivore të grumbulluara nga Aleks Buda, Kristo Frashëri dhe Stefanaq Pollo, Vol II (maj 1913-shtator 1913), f. 83; Beqari, *Letrë nga Elbasani*, “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914, 2.

40 Për më shumë në lidhje me situatën e rënduar politike dhe marrëdhëniet e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës me Fuqitë e Mëdha shih: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, 248-257, 267-277.

i huaj ndaj traditës zakonore vendase e në kundërvënie ndaj tyre për shkak të identifikimit të hapur me Islamin dhe të heshtur me etnicitetin osman/turk.⁴¹ Ndërkaq tradita dhe trashëgimia që sistemi perandorak shtetëror osman kishte krijuar në sjelljen, në të jetuarit, në ndjesinë dhe në psikologjinë e shqiptarëve e konkretisht elbasanasve, nuk mund të zhdukej sa hap e mbyll sytë, me një të rënë të lapsit. Përshtatja e tyre me procesin e zëvendësimit apo të ndryshimit të traditave, ideve, sistemit të kultit, organizimit klerikal dhe marrëdhënia që ata do të ndërtonin me shtetin e tyre do të ishte një proces i gjatë dhe i vështirë.

BIBLIOGRAFI

Arkivi dhe literatura:

- Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), A-IV-335. Materiale arkivore të grumbulluara nga Aleks Buda, Kristo Frashëri dhe Stefanaq Pollo, Vol II (maj 1913-shtator 1913).
- Boucart, Jacques. *Shqipëria dhe Shqiptarët*, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë: 2004.
- Durham, Edith. *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, botim i dytë, Shtëpia botuese “Naum Veqilharxhi”, Tiranë: 1998.
- Dushku, Ledia. *“T’a heqim synë nga Turqia”! Perceptimi rreth turqve Osmanë në ligjërimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës*, “Studime historike” (2015), (3-4, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë.
- Gjermani, Sokol. *Aspekte të jetës së komuniteteve fetare në Shqipëri përgjatë vitit 1913*, “Studime Historike” (2013), 1-2.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi I, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2017.
- Kadilli Daja, Zhuljeta, *Sanxhaku i Elbasanit në kapërcyellin e shekujve XIX-XX. Aspekte të marrëdhënieve agrare*, Shëpia botuese “Mediaprint”, Tiranë: 2021.
- Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasanit (1909-1912)*, Botimet “AlbPaper”, Tiranë: 2004.
- Louis – Jary, Gabriel. *Në Mbretërinë e re të Shqipërisë*, ASD- Studio, Tiranë: 2006.
- Schnapper, Dominique. *Bashkësia e qytetarëve: mbi idenë moderne të kombit*, Tiranë: Dituria, 2008.
- Todorova, Maria. *Ballkani imagjinar. Ballkani si alter ego e Europës*, Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit, 2006.

41 Todorova, *Ballkani imagjinar*, 254.

Shtypi:

- “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 24\6 gusht 1913.
- “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 31 gusht\13 shtator 1913.
- “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 4/17 Vjesht I, 1913.
- “Përlindja e Shqipëriës”, Vlorë, 21/3 Vjesht I, 1913.
- “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 24/6 Vjesht I, 1913
- “Përlindja e Shqipëriës”, Vlorë, 28/10 Vjesht I, 1913.
- “Përlindja e Shqipëriës”, Vlorë, 2/15 Vjesht II 1913.
- “Përlindja e Shqipëriës”, Vlorë, 6/19 vjesht III 1913.
- “Përlindja e Shqipëriës”, Vlorë, 14/27 Dhetuar, 1913.
- “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 23\6 dhjetor 1913.
- “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 3 vjesht I, 1913.
- “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 28 vjesht I, 1913.
- “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 Shenendre 1913.
- “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 18 janar 1914.